

## Vendim nr. 240 datë 18.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 18.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (J) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** JONELA SULAJ, përfaqësuar nga avokate Ana Pertena.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i pjesshëm i vendimeve nr. 1627, datë 30.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendim i pjesshëm i cili është bërë titull ekzekutiv; nr. 00-2023-3565, datë 27.09.2023 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, pika 1, 27, 42, pika 2, 43, 44, 124, 131, shkronjat “f” dhe “i”, 134, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 1, 2 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Jonela Sulaj, në bazë të vendimit nr. 3764, datë 13.07.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është trashëgimtare ligjore e shtetasit të ndjerë H.S., i cili është

aksidentuar nga shtetasi G.J. që drejtonte një mjet motorik ku si pasojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor ka goditur të ndjerin, duke i shkaktuar dëmtime trupore. Shtetasi H.S. fillimisht është shtruar në Spitalin Ushtarak dhe më pas është transportuar nga familjarët për një trajtim më të specializuar në një klinikë jashtë shtetit, ku më pas ka ndërruar jetë. Në lidhje me këtë aksident drejtuesi i mjetit, me vendimin nr. 865, datë 29.09.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor dhe është dënuar. Mjeti motorik i shtetasit G.J. ka qenë i siguruar pranë shoqërisë së sigurimit “Atlantik” sh.a. që ka cilësinë e palës së paditur në këtë proces gjyqësor.

2. Kërkuesja së bashku me trashëgimtarët e tjerë të të ndjerit i janë drejtuar me kërkesë shoqërisë së sigurimit “Atlantik” sh.a. për të përfutur dëmshpërblimin përkatës që vjen nga vdekja e trashëgimlënësit të tyre. Me urdhërpagesën e dëmit shëndetësor nr. 856/1, datë 24.03.2005, pala e paditur u ka ofruar paditësve shumën 658.582 lekë dëmshpërblim, shumë për të cilën kërkuesja dhe trashëgimtarët e tjerë nuk kanë qenë dakord dhe i janë drejtuar në datën 07.02.2006 gjykatës, duke kërkuar detyrimin e shoqërisë “Atlantik” sh.a. të dëmshpërblejë kërkuesen në vlerën e dëmit real me pasojë vdekjen e shtetasit H.S., të ardhur si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga mjeti motorik i siguruar pranë kësaj shoqërie.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5740, datë 19.07.2007, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë “Atlantik” sh.a. që t'i dëmshpërblejë kërkueses vlerën e dëmit real, me pasojë vdekjen e të ndjerit H.S., si dhe kamatëvonesat në pagimin e tij në vlerën 3, 878, 600 lekë, duke pranuar vetëm ekzistencën e dëmit pasuror të përlllogaritur mbi bazën e dekretit nr. 295, datë 15.09.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike ndaj të tretëve”, si dhe shpenzimet spitalore për kurimin jashtë shtetit të të ndjerit, të përcaktuara mbi bazën e disa dokumenteve mjekësore të lëshuara nga shteti grek. Kundër këtij vendimi ka paraqitur apel shoqëria “Atlantik” sh.a.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1416, datë 05.09.2008, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka parregullsi në marrjen si provë të aktit të ekspertimit vlerësues nga një ekspert që nuk ka pasur njohuritë në fushën përkatëse, si dhe të dokumenteve mjekësore të shtetit grek të dërguara me faks, të cilat, në pikëpamje të formës së paraqitjes, nuk përmbushnin kushtet e vlefshmërisë të kërkuara nga legjislacioni shqiptar.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3119, datë 16.04.2010, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes civile, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin

nr. 498, datë 18.11.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3119, datë 16.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6. Më tej, në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9653, datë 30.09.2013, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë, detyrimin e palës së paditur, shoqërisë “Atlantik” sh.a. që t’i paguajë kërkueses shumën 1.342,245 lekë për dëmin që i është shkaktuar nga vdekja e të ndjerit H.S. Mbi këtë shumë duhet të zbatohen edhe kamatëvonesat e përlllogaritura në vlerën 866. 937.11 lekë, shumë kjo që pas ditës së kryerjes së aktit të ekspertimit, datë 24.06.2013, duhet të shtohet edhe me interesin ditor në vlerën 280.11 lekë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1627, datë 30.06.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 9653, datë 30.09.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar pjesërisht kërkesëpadinë; detyrimin e palës së paditur, Shoqërisë së Sigurimeve “Atlantik” sh.a., t’i paguajë kërkueses, dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën totale 2.690.237 lekë, si dhe interesat për këtë shumë në vlerën 1.854.401 lekë, në total (principal plus interes) në vlerën 4.544.638 lekë; rrëzimin e padisë për pjesët e tjera të kërimit. Sipas kësaj gjykate, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është rrjedhojë e një gjykimi të drejtë, të bazuar në ligjin procedural, material civil dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet. Kundër këtij vendimi, kërkuësja dhe pala e paditur, Shoqëria e Sigurimeve “Atlantik” sh.a., kanë ushtruar rekurs ndaj këtij vendimi.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3565, datë 27.09.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1627, datë 30.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi nuk ka respektuar ligjin material dhe procedural civil dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 9653, datë 30.09.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se ky vendim është i drejtë dhe i mbështetur në ligj. Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Tiranë, në kundërshtim me nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, nuk ka bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen dhe nuk e ka zgjidhur atë në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme.

9. Në datën 01.07.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve sipas objektivit, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 06.08.2024.

## II

### Pretendimet e kërkueses

10. *Kërkuësja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi vendimi i gjykatës së rrethit është i njëanshëm, jo i drejtë dhe jo i arsyetuar mirë po mbi të gjitha një vendim që nuk ka marrë parasysh shpenzimet spitalore që familjarët e të ndjerit kanë bërë, duke u shprehur se kërkohet pëlqimi i shoqërisë së sigurimit, arsyetim ky i pabazuar dhe me asnjë bazë ligjore. Në këtë vendim gjykata nuk shprehet për shpenzimet, po ashtu as për fitimin e munguar për sa i përket përlllogaritjes së pensionit suplementar që i ndjeri do të gëzonte e përfitonte nëse nuk do të kishte ndodhur aksidenti. Po kështu, gjykata nuk shprehet as për shpenzimet gjyqësore dhe avokatore, si dhe pagesat e ekspertëve kontabël. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë që mbështet këtë vendim është i gabuar dhe i pambështetur në ligj e në prova.

10.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe brenda një afati të arsyeshëm*, pasi gjykatat nuk kanë respektuar afatin e arsyeshëm, si dhe kanë dhënë vendime të cilat nuk bindin se cili argument vlen ose jo, pavarësisht bazës ligjore të përmendur në të gjitha shkallët e gjykimit, referenca të cilat janë të mbështetura në të njëjtat nene dhe ligje, ndërsa përfundimet e vendimeve janë të ndryshme për nga interpretimi nga njëri gjykim ose trup gjykues tek tjetri. Vendimet e padrejta në të cilat janë lakuar vetëm pak nene nuk kanë respektuar dhe kanë cenuar të drejtat legjitime të kërkueses, duke zhvlerësuar të drejtën e jetës. Gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm, secila sipas mënyrës së vetë, duke cenuar të drejtat kushtetuese të kërkueses dhe duke mos krijuar besim se cila prej tyre ka gjykuar drejt. Ato nuk kanë marrë parasysh në mënyrë substanciale pretendimet e kërkueses në lidhje me shpenzimet spitalore jashtë shtetit, pavarësisht se provohen me prova në formën e kërkuar nga ligji. Gjykatat, pavarësisht provave që i janë vënë në dispozicion, kanë shkelur në mënyrë evidente ligjin material dhe procedural, por edhe praktikën e ngjashme.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

12. Kërkuësja, në rastin konkret, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, ajo i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë, ndërkohë që për vendimin e Gjykatës së Lartë ajo nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në këtë drejtim Gjykata ka vlerësuar se si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, është data e marrjes dijeni efektive për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se ka qenë vetë kërkuësja, e përfaqësuar me avokat, e cili ka paraqitur rekursin për të vënë në lëvizje procesin në Gjykatën e Lartë, që do të thotë se ka pasur interes për të ndjekur fatin e ankimit të tij. Procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuësja ka përfunduar me vendimin nr. 00-2023-3565, datë 27.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 01.07.2024, pra pas 10 muajve. Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi objekt kundërshtimi është publikuar në faqen zyrtare të internetit në datën 22.01.2024, datë në të cilën palët mund ta dispononin si vendim.

16. Për sa më lart, Kolegji, duke u bazuar në jurisprudencën kushtetuese, çmon se kërkuësja prezumohet të ketë marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë ditën e publikimit të vendimit, më 22.01.2024. Nga përmbajtja e ankimit kushtetues individual nuk konstatohet ndonjë rrethanë faktike për marrjen dijeni të vendimit në një datë të mëvonshme. Prandaj, momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkuëses, nga i cili ka filluar afati ligjor 4-mujor, duhet konsideruar data 22.01.2024, kur vendimi është publikuar i arsyetuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe është bërë i disponueshëm për kërkuësen. Duke iu referuar kësaj date, Kolegji vlerëson se kërkuësja nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

17. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterit *ratione materiae* bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Prandaj, në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuësit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.